

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-112/12

**Prishtinë
5 mars 2013**

Në çështjen juridike të:

S. I.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër.

M. P.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/100/2011 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA00773), i datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 5 mars 2011, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet sipas detyrës zyrtare vendimi Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/DA/A/100/2011, i datës 23 shkurt 2011, sa i përket lëndës së regjistruar në KPA me nr. KPA00773, dhe hedhet poshtë kërkesa për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 45 (katërdhjetë e pesë) të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 26 prill 2007 M. P. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së tij të pronës dhe ri-posedimin e pronës që gjendet në Radishevë, Skenderaj, ngastra nr. 1083, arë e klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 21 ari dhe 58 m² si dhe arën e klasës të 6-të në sipërfaqe prej 23 ari e 97 m², në total të 45 ari e 55m². Ai shpjegoi se kishte qenë pronari i kësaj ngastre si dhe se kjo ishte humbur me 1 korrik 1999 si rezultat i rrethanave të 1998/1999 në Kosovë. Rasti u regjistrua në AKP me numër nr. KPA00773.

Në vitin 2009, AKP-ja bëri njoftimin sipas kërkesës duke vendosur njoftimin në vendin ku pretendohet se gjendej ngastra. Në vitin 2011, AKP-a e bëri njoftimin e serishëm për kërkesën, këtë herë duke publikuar kërkesën në Gazetën e njoftimeve nr. 7 si dhe në Buletinin e zyrës së pronave të UNHCR. Gazeta si dhe Lista iu dhanë një përfaqësuesi të fshatit Runik i cili pranoi që do t'u vë atë në dispozicion palëve të interesuara. Po ashtu publikimet u lan edhe në hyrje dhe dalje të Runikut sikurse edhe në disa zyra të shërbimeve në Skenderaj dhe Mitrovicë.

Përderisa askush nuk u përgjigj atëherë kërkesa u trajtua si e pa kontestuar dhe KKPK-ja sipas vendimit të saj KPCC/D/A/100/2011, të datës 23 shkurt 2013 e aprovoi kërkesën.

Me 7 shtator 2012, S. I. (tutje si pala ankuese) paraqiti ankesë, duke theksuar se më parë në vitin 1973/1974, familja e tij e kishte blerë ngastrën nr. 1083 prej O. P.. Ai i ceku disa dëshmitar më emër.

Pala përgjegjëse në kërkesë (tutje si pala përgjegjëse në ankesë) u përgjigj ndaj kësaj ankese. Ai shkroi si më poshtë:

“ I nderuar fqinjë I., Unë, P. M., djali i O. P. nga fshati R, duke e ditur së ai është i sëmurë, në emër të tij deklaroj se:

Është e vërtet se babai i imë ia ka shitur ngastrën e lartcekur Nr. 1083 në sipërfaqe prej 45 ari e 55 m² I. I. në vitin 1974 në prani të dëshmitarëve të cekur në kërkesë.

Prandaj, nuk ka asgjë kontestuese sa i përket kërkesës KPA00773 të S. I., e gjitha që është thënë është e vërtetë”.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme edhe pse pala ankuese nuk ka qenë pala në procedurë para KKKP-së. Rrethana nuk mund të shkoj në dëm të palës ankuese ngase më të vërtet ai nuk është njoftuar për kërkesën në mënyrën e duhur. Njoftimi është bërë me publikimin e kërkesës në Gazetën e Njoftimeve të APK-së dhe Buletinin e UNHCR-së. Kjo, megjithatë, paraqet “përpjekje të arsyeshme” për ta bërë njoftimin e kërkesës ashtu siç kërkohet nga neni 10.1 i rregullores vetëm në raste të veçanta. Një veçanti e tillë në këtë rast nuk mund të gjendet. Përderisa gjykata nuk mund të përjashtoj se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedure, ankesa e tij pranohet.

Vendimi i KKKP-së përderisa është ankimuar është dashtë të anulohet *ex officio* si dhe kërkesa të hidhet poshtë ngase rasti nuk bie brenda fushë veprimit të kompetencave të KKKP-së (Neni 11.4 (a) UNMIK/REG/2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Edhe pse KKKP-ja si organ gjysmë-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashme e ka pranuar kompetencën e vetë, Gjykata e vlerëson sipas detyrës zyrtare nëse rasti bie në fushëveprimin e juridiksionit të saj (neni 195.1 b, e Ligjit të Procedures Kontestimore).

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkeses ka ta drejtë në urdhër nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën në prone por edhe se ai ose ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore sipas rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999.

Në këtë rast, megjithatë, pala përgjegjëse në ankesë në përgjigjen e vetë e vërteton se deklarata e palës ankuese është e vërtet dhe se ngastra i është shitur nga ana e babait të tij tek fqinji i tij Idriz Imeri.

Prandaj, humbja e pronës nuk ka ndonjë lidhje me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

Si pasojë e vendimit të KKPK-së sa i përket kërkesës ajo është dashur të anulohet sipas detyrës zyrtare dhe kërkesa të hedhet poshtë ngase është jashtë juridiksionit të KKPK-së dhe Gjykatës.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifrat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,15 dhe 10.1 të UA 2008/2): 15 €.

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala përgjegjëse në ankesë e cila ka paraqitur kërkesë të papranueshme. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagimin e taksës është 15 ditë. Neni 47.3 parashihet që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatim i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it